



Nr.Prot. 80/24



REPUBLICA

KËRKESË

KËRKUES:

Qendra “Res Publica”,
person juridik i regjistruar në gjykatë
me Vendimin nr. 604 dt. 13.04.2010,
përfaqësuar nga Z. D M

Adresa: Blv “Gjergj Fishta”, Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë
Email: qendra.respublica@gmail.com

DREJTUAR:

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Adresa: “Rruga e Kavajës”, Tiranë

Për dijeni:

Koordinatorës për të drejtën e informimit Znj. Joniada Koçi

OBJEKTI:

Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit

BAZA LIGJORE:

Ligji nr.119 dt. 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar
Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike,

E nderuar Znj.Koordinatorës,

Në lidhje me anëtarën e KPK-së, A F (V), ju fillimisht na informuat se nuk kishit dijeni për ndonjë procedim penal ndaj saj. Pas një kërkesë tjetër për informacion, ju na informuat se nuk jeni njoftuar zyrtarisht për vendimin Nr. 28 datë 11.02.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pushimin e procedimit ndaj znj. F (V) si dhe zonja F (V) nuk ju ka informuar për këto procedime.

Bazuar shkresës të datës 16 mars 2021 nga KLGj (Aneks 1), Znj. A F (V) është shkarkuar si gjyqtare në vitin 1996. Gjithashtu, sipas përgjigjes së KLGj të datës 25 prill 2024, znj. (V) nuk ka bërë ankim në Gjykatën Kushtetuese dhe, pas miratimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 15/1997, nuk ka paraqitur në KLD-në e atëhershme kërkesë për rihapjen e procedurës për shkarkimin e saj (Aneks 2).

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së saj për t'u emëruar si anëtare e një prej organeve të vettingut, ajo nuk iu referua shkarkimit të saj, por vetëm paraqiti procesverbalin e saj disiplinor, i cili megjithatë kishte të bënte me punën e saj në Kuvend. Në të njëjtën kohë, gjatë intervistës së saj para Komisionit parlamentar *ad hoc*, ajo përmendi se ka shërbyer si gjyqtare (Aneks 3),

por nuk ka paraqitur të dhënat e saj të shërbimit gjyqësor, por vetem për punën e saj në Kuvend (Aneks 4).

Siç jeni në dijeni të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen B C kundër Shqipërisë, në të cilin Gjykata Evropiane kritikoi KPA-në se nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për të vërtetuar, në kohën e duhur, nëse z. L D i plotësonte kriteret e emërimit apo ishte emëruar në mënyrë të paligjshme, edhe pse shkarkimi i tij ishte çështje publike dhe për këtë arsye KPA-ja duhet të ishte konsideruar se kishte dijeni për këtë.

Për sa më sipër, kërkojmë të na informoni në lidhje me:

1. A përbën një shkelje disiplinore fakti që nga ana e Znj. F nuk ka informuar institucionin në lidhje me procedimin e iniciuar ndaj saj?
2. Nëse po, cilat janë masat që do ndërmerren nga ana juaj në lidhje me këtë shkelje?
3. A ka ndërmarrë institucioni juaj masa në lidhje me rastin e Znj. F , pasi ju jeni bërë me dije nga media si dhe nga shkresa e Qendrës ResPublica se ndaj anaëtares A F (V) ka një kallëzim penal për veprën penale për falsifikim të dokumentave? Nëse po, cilat janë masat e ndërmarra?
4. A përbën një shkelje fakti që nga ana e Znj. F , nuk ka informuar Komisionin parlamentar *ad hoc*, për shkarkimin nga detyra si gjyqtare fakt i cili u bë mediatik në media të ndryshme?
5. Nëse po, cilat janë masat që do ndërmerren nga ana juaj në lidhje me këtë shkelje?

Kjo kërkesë bazohet në nenin 3 të ligjit të sipërpërmendur, i cili shprehet:

“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.”

Kopje e dokumenteve të sipërpermendura mund të na i dërgoni në adresën e emailit ose në adresën postare:

Adresa: Blv “Gjergj Fishta”, Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë

Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në:

email: gendra.respublica@gmail.com

Informacionet e kërkuara mund të na i dërgoni edhe në formatin elektronik në adresën e mësipërme.

Duke mbetur në pritje të një përgjigjeje të shpejtë dhe pozitive nga ana Juaj, Ju falenderoj për mirëkuptimin.

Me respekt,
Av. D M
Drejtor Ekzekutiv
Qendra “Res Publica”

Datë më 29.04.2024